

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje kazane per mbetjet urbane

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Kodi**

44613700-7 Kazanë mbeturinash

VLERA E FONDIT LIMIT: 29.869.700 (Njëzetë e nëntë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH

Argumentim:

- **Përlogaritja e vlerës së fondit limit :**

Komisioni organizoi punën për Kërkimin dhe Grumbullimin e Informacionit mbi Çmimet Orientuese për mallin, objekt i këtij prokurimi.

Në përfundim të kërkimeve, u vërejt se:

1. **Listat e publikuara** nga INSTAT, nuk përmbajnë të dhëna mbi çmimet e mallrave që kërkohen të prokurohen.
2. **Institucione të tjera zyrtare** të njohura, nuk disponojnë publikime lidhur me çfarë kërkohet.

Grupi u mbështet: Në studimin e tregut vendas, nisur nga kriteret e përcaktuara nga komisioni, në përzgjedhjen e disa subjekteve vendas.

Në mbështetje të nenit 76, pika 1, germa b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

1. **Komisioni organizoi punën** për Kërkimin dhe Grumbullimin e Informacionit mbi Çmimet Orientuese në Treg për të gjithë elementet e kostos së mallrave objekt i këtij prokurimi;
2. Komisioni mori në konsiderat **çmimet e subjekteve që afruan ofertat**
3. **Në hetimin e tregut vendas**, nisur nga kriteret e përcaktuara nga komisioni, në përzgjedhjen e kompanive, sipas së cilës ato duhet të jenë të specializuara në përputhje me kërkesat tona specifike të shprehura në projek si dhe me autoritet në treg, u kontaktua me :

Opratorin ekonomik Luar Bros	me Nipt L72322004M
Opratorin ekonomik Power Industries	me Nipt L51706022H
Opratorin ekonomik Wat 2010 shpk	me Nipt L02017001Q

- Operatori Ekonomik fitues do të realizoj furnizimin dhe vendosjen 90 dite pune nga data e lidhjes së kontratës.
- Transporti do të kryhet nga OE fitues
- Vendi i dorëzimit do të përcaktohet në momentin e levrimit të mallit.

Garancia për mallrat e kërkuar është sipas specifikimeve teknike. 12 muaj

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
- b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 29'000'000 Lek

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kerkesa e mesiperme eshte bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure,si dhe mbeshtetet ne në nenin 77, pika 3, e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43,b

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 date 19.05.2008, Per Procedurat Tatimore ,neni 64 Deklarata Tatimore.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Shërben për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, me qëllim për të parë aftësitë financiare të operatorëve ekonomin

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, *(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kjo kerkese bazohet ne Ligjin nr.9632,date 30.10.2006 ,Per sistemin e taksave vendore i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore per vitin 2021, ligjin nr.131/2015 "Per Qendren Kombetare te Biznesit"neni 3.1(a,b,c). Dokumentat e kerkuara me siper, do te paraqiten nga operatori ekonomik fitues para dhenies se kontrates ose nese kerkohen sqarime nga A.K.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 11’900’000 lekë

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

2. Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që

kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenin 40, pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme _____ të lëshuar nga _____ (shënim- përcaktoni, **nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, llojin e licencës së nevojshme që lidhet me objektin e prokurimit, si dhe institucionin që lëshon licencën e kërkuar**).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe _____.

(shënim - përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të furnizimit, ose nëse është rasti të prodhimit të mallrave objekt prokurimi, që lidhet me objektin e kontratës së prokuruar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me **Çertifikatën ISO 9001:2015** ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme.

Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me **Çertifikatën ISO 14001:2015** ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme.

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **Çertifikate standarti EN 840-2-5-6** të mallit objekt prokurimi.

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **Çertifikate standarti RAL GZ951/1** të mallit objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të

njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kualifikimet/çertifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Kriteri i vendosur në referencë të dispozitave të sipërcituara, i cili përcakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, dhe duhet të jetë i pajisur me certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e ofertuesit me standarde të kërkuara të cilësisë (ISO 9001) dhe të menaxhimit të mjedisit (ISO 14001). Që procedura të realizohet me cilësi dhe konform standardeve mjedisore, operatori duhet të jetë i çertifikuar me certifikatat ISO si më sipër. Pra konsiderohet si kriter i lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe i bazuar në LPP.

Nga ana tjetër, certifikimet e mallit objekt prokurimi për tu paraqitur, shërbejnë për të vërtetuar që mallrat e ofruara respektojnë normat dhe standardet CE (EN 840-2-5-6) në mbështetje të kushteve mjedisore, si edhe cilësisë dhe jetgjatësisë së tyre (RAL GZ951/1).

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacionin i cili vërteton që malli objekt prokurimi është në përputhje me standardin CE

Argumentimi: Referuar nenit 40 pika 6/c, 43 dhe 44 të VKM 285 datë 19.05.2021. Ky certifikim tashmë një standart gjëresisht i kërkuar në fushën e prokurimeve publike, i mundeson AK për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë lehtësimin e mallit në mënyrë cilësore .

2.3.5. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim të prodhuesit/distributorit të autorizuar për mallrat objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim distributori operatori ekonomik duhet ta vërtetojë këtë duke paraqitur akt-marreveshje/autorizim/kontrate lidhur mes kompanisë prodhuese dhe distributorit të autorizuar.

Argumentim: Ky është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në këtë procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht me rregullat të cilësisë së mallrave që kërkohen të blihen dhe që janë prodhuar në standartet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jodiskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtperdrejt me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë shërben për njohjen e mundësisë së OEP përmbushjen me sukses të kontratës. Në bazë të pikës 1 germa a dhe c, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standartet CE/ ose ekuivalent dhe direktivave lidhur si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi

2.3.6 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi, për të gjitha zerat objekt prokurimi në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë mallrat që do të ofrohen.

Argumentim: Ky është një dokument i rëndësishëm, pasi tregon përputhshmërinë e mallrave që do të ofrohen me mallrat e kerkuara nga AK. Ky kriter është jodiskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës si dhe me besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë shërben për njohjen e mundësisë së OE përmbushjen me sukses të kontratës. Në bazë të pikës 1 germa a dhe c, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standartet CE/ ose ekuivalent dhe direktivave lidhur si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

2.3.7 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me standartet e kerkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion justifikues (certifikata/deklarata prodhuesi) për standartet dhe kërkesat që duhet të përmbushin zerat e kerkuara në formularin e specifikimeve teknike.

Argumentim: Ky është një dokument i rëndësishëm, pasi tregon përputhshmërinë e mallrave që do të ofrohen me mallrat e kerkuara nga AK. Ky kriter është jodiskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës si dhe me besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë shërben për njohjen e mundësisë së OE përmbushjen me sukses të kontratës. Në bazë të pikës 1 germa a dhe c, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 germa a dhe pika 6 germa c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar

edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standartit CE/ ose ekuivalent dhe direktivave lidhur si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

2.3.8 Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në formën e një table, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga ofertuesi për të gjithë zerrat objekt prokurimi. Në plotësim të kësaj kerkese Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si mëposhtë:

Nr	Emertimi I produkteve	Emertimi kompanise prodhuese.	Emertimi i katalogut	Referenca ne katallogje (linku)
				KOD iproduktitose nr. Faqes ne katalog

Argumentim: Ky kriter kerkohet qe te behen krahasimet midis produktit te ofruar nga ofertuesi dhe atij qe ofron distributori ose prodhuesin tek i cili OE do te furnizohet. Ky kriter eshte jodiskriminues, eshte ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates si dhe me besueshmerine e OE ofertues per aftesite teknike. Kjo kerkese sherben per njohjen e mundesise se OE per permbushjen me sukses te kontrates. Në bazë të pikës 1 germa a dhe c, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 germa b dhe pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standartit CE/ ose ekuivalent dhe direktivave lidhur si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër dërgimin e mallit në adresat e përcaktuara të AK-ve.

2.4.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

- a.
- b.
- c.

.....
(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, apo të specializuar.kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.4.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- 1.....
*Për mjetet duhet te disponoje, dëshmi, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentat si: Leja e qarkullimit, Çertifikata e Kontrollit Teknik, Foto e mjetit.
Këto kriteret përmbushen nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.5. Kriter për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45, Seksioni III Kërkesa të veçanta sipas tipeve të kontratave, VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: “..Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në **çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave...**”

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhenat e mëposhteme:

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri Bashkia Durrës
Adresa Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës
Tel/Faks 052 22 23 10
E-mail info@durres.gov.al
Ueb-faqe www.durres.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur, Mall

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-58081-02-06-2023

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: Blerje Kazane per mbetje urbane”

5. Fondi limit: 29.869.700 (Njëzetë e nëntë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH.

6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 90 ditë

7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 22.02.2023 Ora: 10:00

Njësia e Prokurimit